

VENDIM
Nr. 187, datë 8.3.2017

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË
KABINETEVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE**

(ndryshuar me vendimin nr. 696, datë 22.11.2017; nr. 1, datë 4.1.2018; nr. 116, datë 23.2.2018; nr. 297, datë 23.5.2018; nr. 446, datë 26.7.2018; nr. 107, datë 6.3.2019; nr. 138, datë 20.3.2019; nr. 214, datë 17.4.2019; nr. 245, datë 24.4.2019; nr. 549, datë 31.7.2019; nr. 784, datë 11.12.2019; nr. 876, datë 18.12.2019; nr. 74, datë 31.1.2020; nr. 235, datë 19.3.2020; nr. 428, datë 3.6.2020; nr. 919, datë 25.11.2020; nr. 1152, datë 24.12.2020; nr. 103, datë 24.2.2021; nr. 513, datë 18.9.2021; nr. 711, datë 24.11.2021; nr. 115, datë 2.3.2022; nr. 443, datë 29.6.2022; nr. 475, datë 13.7.2022; nr. 584, datë 7.9.2022; nr. 620, datë 22.9.2022)¹

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

1/1. Kryeministria, aparatet e ministrive të linjës, administrata e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorisë së Përgjithshme, Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Autoritetit të Konkurrencës, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Entit Rregullator të Energjisë, Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Instituti për Krimet dhe Pasojat e Komunitetit në Shqipëri, Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi, *nëpunësit civilë gjyqësorë dhe nëpunësit civilë të prokurorisë*, Gjykata e Lartë, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ishSigurimit të Shtetit, *Komisioni i Prokurimit Publik, Instituti i Statistikave, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Posaçme, administrata e Shkollës së Magjistraturës, zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.*

1/2. Institucionet qendrore dhe ato rajonale/vendore në varësi të Kryeministrit, ku bëjnë pjesë: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, Agjencia e Prokurimit Publik, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, *Komiteti për Pakicat Kombëtare*, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Instituti i Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, administrata e Akademisë së Shkencave, Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile, Inspektorati Qendror, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, *Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje*, Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal (AKZHR), Agjencia për Zhvillimin Rajonal me qendër në Shkodër, Agjencia për Zhvillimin Rajonal me qendër në Tiranë, Agjencia për Zhvillimin Rajonal me qendër në Korçë, Agjencia për Zhvillimin Rajonal me qendër në Vlorë, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal (AZHER), Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, Komiteti Shtetëror i Kulteve, *Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Sekretariati teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar, Qendra e Botimeve për Diasporën, Avokatura e Shtetit, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASP), Agjencia për Media dhe Informim, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.*

1/3. Institucionet qendrore dhe ato rajonale/vendore në varësi të ministrave të linjës, të cilët në

¹ Për efektet financiare të vendimeve ndryshuese, shih vendimet përkatëse.

kuptimin e këtij vendimi kategorizohen, si më poshtë:

a) Institucionet qendrore të grupit të parë, ku bëjnë pjesë: Drejtoria e Përgjithshme Detare, *Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve*, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në nivel qendror, *Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisë*, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, *Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale*, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Agjencia e Koncesioneve dhe Partneriteteve Publike Private, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, *Qendra e Shërbimeve Arsimore*, nëpunësit civilë në pozicionet mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, punonjësit civilë në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Drejtorinë e Shifrës, në Komandën dhe Shtabin e *Akademisë së Forcave të Armatosura*, Qendrën Kombëtare të Kërkim Shpëtimit, Qendrën e Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Qendra Kombëtare e Biznesit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe Agjencia për Eficiencën e Energjisë, *Agjencia Kombëtare Bërthamore*, *Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore*, *Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë*, *Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara*, *Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë*, *Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë*, *Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar*, *Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore*, *Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile*, *Agjencia e Menaxhimit të Pronës Publike*, *Agjencia Shtetërore për Shpronësim*, *Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve*, *Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore*, *Autoriteti Rregullator Hekurudhor*, *Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve, Incidenteve Hekurudhore dhe Detare*, *Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas*, *Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor*, *Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit*, *Agjencia Kombëtare e Mjedisit*, *Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura*.

b) Institucionet qendrore të grupit të dytë, ku bëjnë pjesë: Administrata e Prefektit, Instituti i Studimeve të Transportit, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit Gjyqësor, *Qendra e Botimeve Zyrtare*, Instituti i Mjekësisë Ligjore, *Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera*, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Komiteti Olimpik Shqiptar, Galeria Kombëtare e Arteve, Muzeu Historik Kombëtar, *Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"*, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Biblioteka Kombëtare, Teatri Kombëtar, Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Komiteti Shqiptar i Birësimeve, Qendra e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit të Sistemit të Ministrisë së Brendshme, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, administrata e universiteteve, shkollave të tjera të larta, Shërbimi i Provës, *Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*, *Agjencia Kombëtare e Falimentimit*, *Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil*, Teatri Kombëtar i Komedisë, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, punonjësit civilë në Komandën dhe Shtabin e Forcës Tokësore, Komandën dhe Shtabin e Forcës Detare, Komandën dhe Shtabin e Forcës Ajrore, Komandën dhe Shtabin e Komandës Mbështetëse, *Qendrën e Kulturës*, *Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeun e Forcave të Armatosura*, Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura, Qendrën e Personel Rekrutimit, Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Qendrën e Doktrinës dhe Kërkimit në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, punonjësit civilë jomësimorë në Akademinë e Forcave të Armatosura, Akademinë e Nënoficerëve, Shkollën e Trupës dhe Qendrën e Stërvitjes Individuale në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, Qendrën e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës, Çirku Kombëtar, *Agjencia Kombëtare e Rinisë*, Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional, Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, *Sekretariati Kombëtar i Nismës për Transparençë në Industrinë Nxjerrëse (EITI - Shqipëri)*, *Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar*, *Qendra*

e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë, Drejtoria e Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë.

c) Institucionet qendrore të grupit të tretë, ku bëjnë pjesë: Qendra Pritëse e Viktimave të Trafikut, Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve, *Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore*, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit Sarandë, Zyrat e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike, Agjencia e Shërbimeve të Sportit Tiranë, *Qendra Muzeore Krujë - Muzeu Kombëtar "Skënderbeu", Muzeu Etnografik Krujë, Qendra Muzeore Berat - Muzeu i Ikonografisë "Onufri", Muzeu Etnografik Berat, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar*, Federatat e Sportit, *Qendra e Pritjes për Azil*, Shtëpia e Pushimit e Ministrisë së Brendshme Durrës, Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor, Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme, Sektori i helikopterëve të Repartit Special Renea dhe punonjësit civilë në Shtëpitë e Pushimit të sistemit në Ministrinë së Mbrojtjes, Qendrën e Bashkuar Operacionale të Forcave të Armatosura, Qendrën e Menaxhimit të Materialeve, Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura, Policinë Ushtarake, Batalionin e Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Batalion/kompani/qendra stërvitore në Forcën Tokësore, Flotiljen Detare/Shërbimin Hidrografik/Qendrën e Vëzhgimit Detar/Qendrën e Zhytjeve/Qendrën Stërvitore/Kompani në Forcën Detare, Baza Ajrore/Shërbimin Meteorologjik Ushtarak/ Qendrën e Kontroll Raportimit/Qendrën Stërvitore/Kompani në Forcën Ajrore, Batalion/Kompani/Qendrën Stërvitore në Komandën Mbështetëse, Kompani/Qendra në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, *Qendra Muzeore Durrës.*

2. Struktura dhe vlerat e pagave sipas kategorive për nëpunësit civilë dhe nëpunësit në të gjitha institucionet e cituara në pikën 1 më sipër, të jetë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Elementët e pagës janë si vijon:

a) Paga e grupit, kolona 2, e lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, përcaktohet sipas lidhjeve përkatëse të këtij vendimi dhe vlera e saj është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 3), e lidhjes nr. 1, jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi *apo në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi* me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

c) Shtesa për kualifikim (kolona 4), për nëpunësit në pozicionet "Sekretar i Përgjithshëm", "Anëtar i Organeve Kolegjiale drejtuese me kohë të plotë të institucioneve të pavarura, të përcaktuara në pikën 1/1, të këtij vendimi", "Drejtor departamenti", "Drejtor i përgjithshëm", "Drejtor drejtorie dhe pozicionet e veçanta të punës, të kategorizuara në kategorinë II-b ose më të lartë, sipas këtij vendimi, në institucionet e përcaktuara në pikën 1/1, të këtij vendimi", "Titullar dhe zëvendëstitullar i institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës", "Prefekt", "Nënprefekt", si dhe funksionarët politikë "Zëvendësministër" e anëtarë të kabineteve, përfitojnë shtesën për kualifikimin, gradën apo titullin shkencor, të përcaktuar sipas lidhjes nr. 2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Kriteret e përfitimit të shtesës janë:

- Kjo shtesë jepet kur kualifikimi, grada apo titulli shkencor, përputhen me përshkrimin e punës së nëpunësit, por pas miratimit, rast pas rasti, nga Departamenti i Administratës Publike, për Kryeministrinë, aparatet e ministrive të linjës, institucionet qendrore/rajonale vendore në varësi të Kryeministrit, institucionet qendrore/rajonale vendore në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit, si dhe nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, për institucionet e pavarura.

- Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull shkencor më të lartë se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr. 2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfiton vetëm shtesën e përcaktuar për pozicionin.

- Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull shkencor më të ulët se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr. 2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfiton shtesën në përputhje me kualifikimin, gradën apo titullin shkencor që ka.

Në çdo rast, si më sipër, pavarësisht nga kualifikimi, grada apo titulli shkencor që ka nëpunësi, ai përfiton shtesën vetëm për gradën apo titullin shkencor më të lartë që ka.

Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të kësaj pike.

Shtesa për kualifikim (kolona 4) e lidhjes nr. 1, për të gjitha pozicionet e tjera të jetë 0.

ç) Shtesa për pozicion është sipas kolonës 5, të lidhjes nr. 1.

Kategoritë e pagave për pozicionet e punës me emërtesë të njëjtë, të përcaktohen në kuadër të miratimit të strukturës dhe të organikës së secilit institucion.

2/1. Në kuptim të këtij vendimi:

a) njësitë teknike të përmbajtjes, njësitë/drejtoritë/ sektorët e përmbajtjes dhe drejtoritë/ sektorët teknikë janë ata/ ato, që realizojnë funksionet për të cilat është krijuar dhe funksionon institucioni. Në to nuk përfshihen strukturat organizative përgjegjëse për funksionet horizontale të institucionit, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore;

b) njësitë/drejtoritë/ sektorët apo specialistët mbështetës janë ato/ ata që kryejnë funksionet horizontale të institucionit, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

3. Kategorizimi për pozicionet e veçanta të punës për funksionet e veçanta në ministratë e linjës dhe institucionet e pavarura, të jetë sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3/1. Kategorizimi për pozicionet e veçanta të punës, për funksionet e veçanta në Kryeministri, të jetë sipas lidhjes nr. 3/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3/2. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës në Departamentin e Administratës Publike, të jenë sipas lidhjes nr. 3/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3/3. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës në Shkollën e Magjistraturës të jenë sipas lidhjes nr. 3/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3/4. Nivelet e pagave të pozicioneve “ekspertë”, në qendrat e ekselencës, pjesë e strukturës dhe organikës së institucioneve të administratës shtetërore, të jenë sipas lidhjes nr. 3/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Nëpunësit në këto pozicione nuk përfitojnë elemente të tjera të pagës apo shtesa të tjera të përcaktuara në këtë vendim apo në akte të tjera.

4. Për natyrë të veçantë pune jepet një shtesë mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse, e konkretisht:

4/1. “Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët e drejtorive”, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit “Master i Shkencave/Master Profesional/ Bachelor” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike”, “Inxhinieri informa-tike”, “Informatikë”, “Inxhinieri telekomunikacioni”, “Teknologji informacioni”, “Informatikë ekonomike”, “Inxhinieri matematike informatike” apo “Shkenca kompjuterike”, në masën:

- 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK, të cilët punojnë me bazat e të dhënave shtetërore, në institucionet e përcaktuara në pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3, të këtij vendimi.

Aplikimi i kësaj shtese bëhet vetëm në rastet kur institucionet kanë krijuar baza të të dhënave shtetërore, të miratuara e të regjistruara pranë Autoritetit Rregullator Koordinues të Bazave të të Dhënave Shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi.

- 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK, të institucioneve të përcaktuara në pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3, të këtij vendimi, të cilët nuk punojnë me bazat e të dhënave shtetërore.

- 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK, të institucioneve rajonale/vendore.

Zbatimi i shtesave, si më sipër, për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike, sipas përshkrimit të pozicionit të punës.

Përjashtohen nga ky parashikim nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe të Qendrës së Teknologjisë për Sistemin e Drejtësisë.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të vërë në dispozicion të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave listën e përditësuar të institucioneve që kanë krijuar baza të të dhënave shtetërore dhe janë regjistruar si të tilla pranë këtij institucioni, sipas legjislacionit në fuqi.

Në rast se, për institucionet ku janë të punësuar nëpunësit në pozicionet e sipërpërmendura

parashikohen shtesa të tjera, nëpunësit e strukturave TIK do të zgjedhin ndërmjet shtesave, por në asnjë rast nuk mund t'i përfitojnë të gjitha shtesat.

4/2. Në Kryeministri, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit civilë në pozicionet:

a) “Drejtore departamenti”, “drejtore njësie”, “drejtore drejtorie”, “jurist” dhe “koordinator”, në departamentet përgjegjëse për zhvillimin dhe mirëqeverisjen, si dhe përgjegjëse për çështjet rregullatore dhe përputhshmërinë;

b) “Drejtore departamenti”, në departamentin përgjegjës për administrimin;

c) “Drejtore njësie” në njësinë përgjegjëse për buxhetin dhe administrimin;

d) “Drejtore drejtorie” në drejtorinë përgjegjëse për administrimin e brendshëm;

e) “Koordinator” në njësinë e menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

4/3. Në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nëpunësit në pozicionet “Inspektor i lartë” dhe “Ndihmësin inspektor i lartë”, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

4/4. Në Komisionin e Prokurimit Publik, nëpunësit në drejtoritë apo sektorët teknikë të përmbajtjes, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

4/5. Në Agjencinë e Prokurimit Publik, nëpunësit në pozicionet “Titullar institucioni”, “Drejtore drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” në drejtoritë dhe sektorët teknikë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

4/6. Në Agjencinë e Koncesioneve dhe Partneriteteve Publike Private, nëpunësit në pozicionin “Titullar i institucionit”, në masën 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë në muaj, ndërsa nëpunësit në pozicionet “Drejtore drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në drejtoritë dhe sektorët teknikë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

4/7. Punonjësit e degëve të thesarit që punojnë në sistemin AMoFTS, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për pozicionin përgjegjës i degës së thesarit Tiranë; 7 000 (shtatë mijë) lekë në muaj për punonjësit e tjerë të degës së thesarit Tiranë dhe 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj për degët e tjera të thesarit.

4/8. Në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, nëpunësit në pozicionet “Titullar i institucionit” dhe “Administrator”, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

4/9. Në Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatrin Kombëtar të Komedisë, Cirkun Kombëtar, punonjësit e trupës artistike në këto institucione, në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.

4/10. Në Drejtorinë e Shifrës, nëpunësit në pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

4/11. Në Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, nëpunësi në pozicionin “Titullar i institucionit”, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, ndërsa nëpunësit në pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “Inspektor”, në sektorët teknikë, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

4/12. Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nëpunësit civilë në pozicionet “Sekretar i Përgjithshëm”, “Drejtore i Përgjithshëm”, “Drejtore drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” në njësitë teknike të përmbajtjes, si dhe funksionarët në pozicionet “Drejtore i kabinetit të ministrit”, “Zëdhënës” dhe “Këshilltar”, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

4/13. Në drejtorinë e përgjithshme, përgjegjëse për kodifikimin dhe harmonizimin e legjislacionit, në Ministrinë e Drejtësisë, nëpunësit në pozicionet “drejtore i përgjithshëm”, “drejtore drejtorie”, “përgjegjës sektori” dhe “specialist”, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

4/14. Shfuqizuar.

4/15. Në Departamentin e Administratës Publike, nëpunësit civilë në pozicionet “Drejtore Departamenti”, “Drejtore Drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në njësitë teknike të përmbajtjes, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

4/16. Në Kryeministri, nëpunësit civilë dhe funksionarët në pozicionet “Sekretar i Përgjithshëm dhe “Drejtore i Kabinetit të Kryeministrit”, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë.

4/17. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, nëpunësit civilë të njësisë së ekzaminimit, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

4/18. Në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, nëpunësit civilë në pozicionet “Titullar institucioni”, “Drejtore drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në njësitë teknike të përmbajtjes, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

4/19. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, titullari i institucionit dhe, për njësitë teknike të përmbajtjes

nëpunësit civilë në pozicionet, “Drejtor drejtorie”, “Përgjegjës sektori”, “Menaxher cilësie” dhe “Specialist”, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

4/20. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave:

a) në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësin në pozicionin “Përgjegjës i sektorit të gjuhëve të rralla”;

b) në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet “Specialist të gjuhëve të rralla” (osmanolog, bizantolog dhe latinolog).”.

4/21. Në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, “titullari i institucionit” dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj.

5. Përfitojnë një shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin nëpunësit në pozicionet:

- Përgjegjës i sektorit të arkivit” dhe “Specialist arkivi”, në Kryeministri, Presidentë, Kuvend, aparatet e ministrive të linjës, në pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” në drejtoritë apo sektorët e përmbajtjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe drejtoritë rajonale/vendore të sistemit të arkivave të shtetit, në pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist arkivi” në sektorin përgjegjës për arkivin në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe në pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.

- “Përgjegjës sektori” dhe “Laborant” në laboratorët e naftës e të gazit dhe laboratorët e lëkurë-tekstileve, si dhe “Inspektor” të naftës dhe gazit në Doganë, autobus, cisternë dhe depozitë tokësore, në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial;

- “Nëpunësit” në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura, në Laboratorin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe në Laboratorin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

- “Stenograf, regjistruar audio”, në Kryeministri, specialist redaktor në Kuvendin e Shqipërisë, dhe specialist stenograf redaktor në administratën e Presidentit.

- Nëpunësit në njësitë e përmbajtjes së Bibliotekës Kombëtare, përjashtuar titullarin dhe zëvendës titullarin e institucionit. Njësitë e përmbajtjes së institucionit përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organikës së Bibliotekës Kombëtare.

Kjo shtesë aplikohet në masën dhe sipas rregullave e kriterëve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës.

6. Struktura dhe nivelet e pagave për zëvendësministrin, prefektin, nënprefektin, nëpunësit e kabineteve në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrive të linjës dhe prefekturë janë, si vijon:

- Zëvendësministër 153 300 lekë;

- Kryetar i Komitetit për Pakicat Kombëtare - 153 300 lekë;

- Drejtor i Kabinetit të Presidentit, të Kryeministrit, të Kryetarit të Kuvendit, të Prokurorit të Përgjithshëm, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe të Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-a.

- Zëvendësdrejtor i Kabinetit të Kryeministrit 154 900 lekë.

- Analist në kabinetin e Kryeministrit 152 200 lekë.

- Këshilltari i Presidentit, i Kryeministrit, i Kryetarit të Kuvendit, i Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Këshilltari për Protokollin i Kryeministrit, Këshilltari për Protokollin i Presidentit, zëdhënësi i Presidentit, Drejtori i Kabinetit të zëvendëskryeministrit, Drejtori i Kabinetit të Avokatit të Popullit barazohen në pagë me zëvendësministrin;

- Këshilltari i Prokurorit të Përgjithshëm, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë, i Avokatit të Popullit, Ndihmësi i Presidentit, i Kryeministrit dhe i Kryetarit të Kuvendit dhe Këshilltari i zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-b.

- Ndihmësi i Zëvendëskryeministrit dhe i nënkryetarit të Kuvendit, Drejtori i Kabinetit të ministrit dhe drejtorët e kabineteve të titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në pikën 1/1 më sipër, barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-a.

- Këshilltari i ministrit, zëdhënësi i ministrit dhe këshilltarët dhe zëdhënësi i titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në pikën 1/1 më sipër, barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-b.²

²Në pikën 6, sipas vendimit nr. 711, datë 24.11.2021, paragrafët që përcaktojnë pagesat për këshilltarët dhe ndihmësit e jashtëm ndryshohen, si më poshtë vijon:

Kryeministri ka të drejtë të ketë këshilltarë të jashtëm dhe ndihmës të jashtëm. Pagesa e tyre mujore përcaktohet nga Kryeministri, në masën deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj për këshilltarët e jashtëm dhe deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë në muaj për ndihmësit e jashtëm.

Përfundimisht, Kryeministri ka të drejtë të angazhojë si këshilltarë të jashtëm edhe shtetas të huaj, ekspertë/konsulentë të njohur ndërkombëtarisht, me një pagesë jo më shumë sesa 1 000 000 (një milion) lekë në muaj, për një periudhë angazhimi jo më shumë se sa kohëzgjatja e mandatit të tij.

- Prefekt 153 300 lekë;

- Nënprefekt 123 000 lekë;

- Këshilltari i Prefektit të Qarkut të Tiranës 69 800 lekë.

- Zëdhënësi i Prefektit të Qarkut të Tiranës 59 300 lekë.

- Sekretari i Presidentit, i Kryeministrit, i Kryetarit të Kuvendit, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë, i Prokurorit të Përgjithshëm, i Zëvendës-kryeministrit, i Nënkyetarit të Kuvendit dhe i Avokatit të Popullit 73 500 lekë.

- Sekretari i ministrit, sekretar në zyrën e Avokatit të Popullit, sekretar i titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të sekretari i organit kolegjal drejtues, sekretar në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës dhe institucionet e pavarura, të përmendura në pikën 1/1 të këtij vendimi 61 950 lekë.

Shtesa për vjetërsi në punë për të gjitha pozicionet “Sekretar”, jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë për femrat dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

Të drejtën për të pasur këshilltarë të jashtëm e ka vetëm Kryeministri. Pagesa e tyre mujore është deri në 40% të pagës mujore të këshilltarit të brendshëm. Masa e pagesës përcaktohet nga Kryeministri. Të drejtën për të pasur ndihmës të jashtëm e ka vetëm Kryeministri. Pagesa e tyre mujore është deri në 40% të pagës së kategorisë I-b. Masa e pagesës përcaktohet nga Kryeministri.

Presidenti i Republikës ka të drejtë të ketë këshilltarë të jashtëm. Pagesa e tyre mujore përcaktohet nga Presidenti, në masën deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj.

Titullari i Agjencisë së Trajtimit të Pronës ka të drejtë të ketë një këshilltar të jashtëm. Pagesa e tij mujore është sipas kategorisë III-a.

7. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve civilë/nëpunësve në institucionet e përcaktuara sipas pikës 1/1, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7/1. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve civilë gjyqësorë në gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, si dhe nëpunësve civilë të prokurorisë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, janë sipas lidhjes nr. 4/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

7/2. Nivelet e pagave për funksionarët e kabineteve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë janë sipas lidhjes nr.4/2/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë janë sipas lidhjes nr.4/2/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7/3. Nivelet e pagave për funksionarët e kabinetit në Prokurorinë e Posaçme janë sipas lidhjes nr. 4/3/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në Prokurorinë e Posaçme janë sipas lidhjes nr. 4/3/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7/4. Nivelet e pagave për funksionarët e kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë sipas lidhjes nr. 4/4/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë sipas lidhjes nr. 4/4/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7/5. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist”

Zëvendëskryeministri dhe ministrat kanë të drejtë të kenë këshilltarë të jashtëm. Pagesa e tyre mujore përcaktohet përkatësisht nga zëvendëskryeministri apo ministri që punëson këshilltarin e jashtëm, në masën deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë në muaj.

Titullarët e institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave, me qëllim realizimin me efektivitet dhe eficientë të misionit dhe objektivave të institucionit që drejtojnë, kanë të drejtë që, për të marrë këshillimin e dubur për çështje specifike, të kenë këshilltarë të jashtëm. Pagesa e tyre mujore përcaktohet nga titullari i institucionit të varësisë që punëson këshilltarin e jashtëm, në masën deri në 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë në muaj.

Pagesa e këshilltarëve të jashtëm dhe ndihmësve të jashtëm bëhet nga llogaria ekonomike e përcaktuar, sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për financa.

dhe “Drejtor ekzekutiv” në Qendrën për Teknologjinë e Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, janë sipas lidhjes nr. 4/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në institucionet e përcaktuara sipas pikës 1/2, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/1. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, janë sipas lidhjes nr. 5/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/2. Nivelet e pagave për punonjësit efektivë kërkimorë e shkencorë në Akademinë e Shkencave, janë sipas lidhjes nr. 5/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/3. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në Inspektoratin Qendror dhe në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, janë sipas lidhjes nr. 5/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/4. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Sekretariatën Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, janë sipas lidhjes nr. 5/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/5. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar i institucionit”, në Agjencinë Telegrafike Shqiptare, janë sipas lidhjes nr. 5/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/6. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar i institucionit”, në Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, janë sipas lidhjes nr. 5/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/7. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm janë sipas lidhjes nr. 5/7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/8. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Agjencinë e Prokurimit Publik janë sipas lidhjes nr. 5/8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/9. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Drejtor ekzekutiv”, në sekretariatën teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar, janë sipas lidhjes nr. 5/9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/10. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës në administratën e Avokaturës së Shtetit janë sipas lidhjes nr. 5/10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nëpunësit e Avokaturës së Shtetit, të cilët deri në datën 10.2.2012 përfitonin një pagë më të lartë sesa parashikohet në lidhjen nr. 5/10, do të vazhdojnë të përfitojnë pagën e mëparshme. Nëpunësit e tjerë përfitojnë pagat sipas përcaktimit në lidhjen nr. 5/10.

Nëpunësi i emëruar jashtë vendit, në pozicionin “Jurist pranë Misionit të Përbërshëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Evropës, i cili është përfaqësues i përbërshëm pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, ka statusin financiar të përfaqësuesit të ministrisë së linjës në përfaqësinë tonë diplomatike pranë BE-së.

8/11. Nivelet e pagave për punonjësit kërkimorë e shkencorë dhe nëpunësit në Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët janë sipas lidhjes nr. 5/11, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/12. Kategoritë e pagave të nëpunësve për emërtesat “drejtor i përgjithshëm”, “koordinator”, “drejtor drejtorie”, “përgjegjës sektori” dhe “specialist”, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, janë sipas lidhjes nr. 5/12, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/13. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Zëvendës-drejtor i Përgjithshëm”, “Zëdhënës i ministrit”, “Koordinator”, “Drejtor drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në Agjencinë për Media dhe Informim, janë sipas lidhjes nr. 5/13, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në institucionet e përcaktuara sipas pikës 1/3/a, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/1. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, janë sipas lidhjes nr. 6/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/2. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, janë sipas lidhjes nr. 6/2, që i bashkëlidhet këtij

vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/3. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në Agjencinë e Trajtim të Pronës, të jenë sipas lidhjes nr. 6/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/4. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, janë sipas lidhjes nr. 6/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/5. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, janë sipas lidhjes nr. 6/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/6. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” (punonjësit civilë) në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Komandën dhe Shtabin e Akademisë së Forcave të Armatosura, si dhe Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit janë sipas lidhjes 6/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/7. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të punonjësve të sistemit doganor, janë sipas lidhjes nr. 6/7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nëpunësit/punonjësit e kategorizuar në kategoritë C3, D1, D2, dhe D3, të lidhjes nr. 6/7, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë, në masën 1% mbi pagën e pozicionit pas çdo viti pune, deri në 25 vjet.

9/8. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të punonjësve të sistemit tatimor, janë sipas lidhjes nr. 6/8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/9. Shfuqizuar.

9/10. Kategoritë e pagave dhe shtesa për natyrë të veçantë pune dhe vështirësi shërbimi të pozicioneve civile të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Zëvendësudrejtor i Përgjithshëm”, në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të jenë sipas lidhjes nr. 6/10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Pozicionet në funksione operationale, operationale mbështetëse dhe mbështetës, në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organikës së kësaj agjencie.

9/11. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Agjencinë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara janë sipas lidhjes nr. 6/11, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/12. Shfuqizuar.

9/13. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, janë sipas lidhjes nr. 6/13, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/14. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Drejtorinë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar janë sipas lidhjes nr. 6/14, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/15. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në nivel qendror janë sipas lidhjes nr. 6/15, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/16. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Agjencinë e Menaxhimit të Pronës Publike janë sipas lidhjes nr. 6/16, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/17 Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, janë sipas lidhjes nr. 6/17, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në institucionet e përcaktuara sipas pikës 1/3/b, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nëpunësit e Sekretariatit Kombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI - Shqipëri), të cilët sipas organizimit të mëparshëm kanë pasur emërtesën “koordinator” dhe një nivel page më të lartë se përcaktimi i këtij vendimi, do të vazhdojnë të përfitojnë pagën që kanë pasur sipas organizimit të mëparshëm.

10/1. Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe

Ansamblit Popullor, Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatrin Kombëtar të Komedisë dhe Cirkun Kombëtar janë sipas lidhjes nr. 7/1 (pjesët I, II, III dhe IV), që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Vjetërsia në punë për punonjësit, që paguhen sipas lidhjes nr. 7/1, jepet në masën 2% pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi vlerën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë.

10/2. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, janë sipas lidhjes nr. 7/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/3. Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Qendrën e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe trupën artistike në Batalionin e Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, janë sipas lidhjes nr. 7/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Vjetërsia në punë për punonjësit që paguhen sipas lidhjes nr. 7/3, jepet në masën 2% pas çdo viti pune deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë.

10/4. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” (punonjës civilë) në Komandën dhe Shtabin e Forcës Tokësore, Komandën dhe Shtabin e Forcës Detare, Komandën dhe Shtabin e Forcës Ajrore, Komandën dhe Shtabin e Komandës Mbështetëse, Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura, Qendrën e Personel- Rekrutimit, Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Qendrën e Doktrinës dhe Kërkimit në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, Qendrën e Stërvitjes Individuale në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, Qendrën e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse, si dhe për punonjësit civilë jomësiorë në Akademinë e Forcave të Armatosura, Akademinë e Nënoficerëve dhe Shkollën e Trupës, janë sipas lidhjes nr. 7/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/5. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në Koordinator i Përgjithshëm, në administratën e Prefektit, janë sipas lidhjes nr. 7/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/6. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” dhe “Drejtor i Përgjithshëm”, në Agjencinë e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë, janë sipas lidhjes nr. 7/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në institucionet e përcaktuara sipas pikës 1/3/c, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11/1. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në institucionet në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, që përcaktohen në pikën 1/3/c, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 8/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11/2. Vlera e pagës për pozicionet e punës dhe shtesa për kushte pune në sektorin e helikopterëve të Repartit Special Renea, janë sipas lidhjes nr. 8/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Vjetërsia në punë për punonjësit që paguhen sipas lidhjes nr. 8/2, jepet në masën 2% pas çdo viti pune deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë.

12. Kategoritë e pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në institucionet rajonale/vendore, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, ministrave të linjës, në institucionet rajonale/ vendore, në varësi të institucioneve të përcaktuara në pikën 1, në institucionet vendore në varësi të institucioneve rajonale, të punonjësve që kryejnë funksione të deleguara të pushtetit qendror në pushtetin vendor, të drejtorëve të ujitjes dhe kullimit, administratave rajonale të zonave të mbrojtura, të komisioneve vendore të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë Prefektit të Qarkut, të nëpunësve civilë në pozicionet mbështetëse “Specialist”, “Shef seksioni” dhe “Përgjegjës/shef sektori”, në drejtoritë e policisë në qarqe, në komisariate dhe reparte autonome, si dhe të punonjësve civilë në qendrat e rekrutimit dhe mobilizimit dhe komandat e mbështetjes rajonale, të sistemit të Forcave të Armatosura, të jenë sipas lidhjes nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Inspektorët veterinarë kufitarë, inspektorët fitosanitarë kufitarë dhe inspektorët e shërbimit të Inspektoratit Ushqimor, të sistemit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, të cilët bëjnë pjesë në grupet e kontrollit doganor, të paguhen me kategorinë IV-a.

12/1. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar

institucioni” në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar janë sipas lidhjes nr. 9/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12/2. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në rrethe janë, sipas lidhjes nr. 9/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12/3. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në zyrat (drejtoritë) rajonale janë sipas lidhjes nr. 9/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12/4. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në komisionet vendore të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë Prefektit të Qarkut, janë sipas lidhjes nr. 9/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12/5. Kategoritë e pagave të nëpunësve civilë në pozicionet mbështetëse “Specialist”, “Shef seksioni” dhe “Përgjegjës/shef sektori”, në drejtoritë e policisë në qarqe, komisarate dhe reparte autonome, janë sipas lidhjes nr. 9/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12/6. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i qendrës”, në qendrat e mbrojtjes civile në qark, janë sipas lidhjes nr. 9/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12/7. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i degës”, në degët rajonale të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, janë sipas lidhjes nr. 9/7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

13. Funksionarët politikë, nëpunësit e kabineteve dhe nëpunësit civilë/nëpunësit që përfshihen në fushën e veprimit të këtij vendimi, nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagë, të përcaktuara me vendime të tjera të Këshillit të Ministrave.

14. Pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve të përfshira në fushën e veprimit të këtij vendimi, përcaktohen në bazë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës.

14/1. Punonjësit në projektet me tituj “Projekte me KfW”, “Projekti i kanalizimeve të Tiranës së Madhe”, “Projekti i shërbimeve esenciale”, në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, deri në përfundimin e projektit përkatës të trajtohen me pagë:

- drejtues projekti (koordinator) - kategoria II-a;*
- specialist - kategoria III-b.*

Punonjësit në projektet e programeve IPA në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, deri në fund të vitit 2019, të trajtohen me pagë, si më poshtë vijon:

- drejtues projekti (koordinator) - kategoria II-a;*
- specialistët - kategoria III-b.*

Për vitin 2020 e në vijim, punonjësit e projekteve të programeve IPA në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve të trajtohen me pagë njësoj si nëpunësit e tjerë të kësaj agjencie.

15. Vendimi nr. 545, datë 11.8.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/ nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar, dhe vendimi nr. 455, datë 8.7.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për pagat dhe shtesat mbi pagë të punonjësve të shërbimit pyjor”, i ndryshuar, shfuqizohen.

16. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2017:

- Për rritjet e vlerave të pagave për institucionet pjesë të fushës së veprimit, si dhe të aplikimit të shtesës për natyrë të veçantë pune, për Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, Departamentin e Administratës Publike dhe Institutin e Statistikave, të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, për politikat e reja të pagave.

- Për të gjitha ndryshimet e ndodhura në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, përfshirë edhe ato të politikave të pagave, të përballohen nga fondet e miratuara për vitin 2017, për këtë sistem.

- Për të gjitha ndryshimet e tjera në këtë vendim, të përballohen nga fondet e miratuara për vitin 2017, për secilin institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Struktura e pagave për nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi

Klasa	Kategoritë	Paga mujore			
		Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		2	3	4	5
	1	Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV), në përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
I	I-a		2%		141.900
	I-b		2%		129.800
II	II-a		2%		118.100
	II-b		2%		100.000
III	III-a		2%	0	80.800
	III-a/1		2%	0	70.500
	III-b		2%	0	61.000
IV	IV-a		2%	0	49.000
	IV-b		2%	0	38.000
	IV-c		2%	0	29.500

Lidhja nr. 2

Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera (lekë)
1	Master i Shkencave. Master i Arteve, <i>Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike</i> Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	14 000
2	Master Profesional. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	11 000
3	Bachelor. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	10 000

Lidhja nr. 2/1

Pozicioni	Kualifikimi/grada/titulli shkencor	Shtesa (lekë/muaj)
Zëvendësministër,	Profesor.	30.000
Drejtor i Kabinetit të Presidentit/ Kryetarit të Kuvendit/	Profesor i asociuar.	25.000
Kryeministrit/Zëvendëskryeministrit.		
Këshilltar i Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit/Zëvendëskryeministrit.		
Zëvendësdrejtor i Kabinetit të Kryeministrit.		
<i>Analist në kabinetin e Kryeministrit.</i>		
Ndihmës i Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit.		

Sekretar i Përgjithshëm. Prefekt. Titullar i institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës. Anëtar i organeve kolegjiale drejtuese me kohë të plotë të institucioneve të pavarura të përcaktuara në pikën 1/1 të vendimit.		
Ndihmës i zëvendëskryeministrit. Drejtor kabineti i ministrit/ titullarëve të institucioneve të pavarura të përcaktuara në pikën 1/1 të vendimit. Këshilltar i ministrit/titullarëve të institucioneve të pavarura të përcaktuara në pikën 1/1 të vendimit. Zëvendëstitullar i institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës. Nënprefekt. Drejtor departamenti. Drejtor i përgjithshëm. Drejtor drejtorie dhe pozicionet e veçanta të punës të kategorizuar në kategorinë II-b ose më lart, sipas këtij vendimi, në institucionet e përcaktuara në pikën 1/1 të vendimit.	Doktor i shkencave;	20.000
	Doktor i shkencave në vendet e përcaktuara sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit të Arsimit, Departamentit të Administratës Publike dhe ministrit të Financave.	25.000
	- Studime postmaster sipas përcaktimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në vendet e përcaktuara sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit, Departamentit të Administratës Publike dhe ministrit të Financave; - të barasvlershme me studimet postmaster në vendet e përcaktuara sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit të Arsimit, Departamentit të Administratës Publike dhe ministrit të Financave; - diplomat master të lëshuara në sistemin anglo-sakson; - diplomat master të fituara në përfundim të programeve universitare që realizohen me jo më pak se 60 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit akademik në një nga vendet e listës bashkëlidhur udhëzimit të përbashkët vetëm për nëpunësit e diplomuar më parë në programet e studimeve universitare, që kanë zgjatur minimumi 4 vite akademike (8 semestra) para zbatimit të sistemit të Bolonjës dhe nëpunësit që kanë përfunduar programet e studimeve të ciklit të dytë sipas sistemit të Bolonjës.	20.000

Lidhja nr. 3

Kategorizimi për pozicionet e veçanta të punës për funksionet e veçanta në ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura

Institucioni	Pozicioni	Kategoria e pagës
Ministria e Punëve të Jashtme	Drejtor i Institutit të Diasporës	II-b
Ministria e Drejtësisë	Inspektor për Inspektimin gjyqësor Inspektor për inspektimin e prokurorisë Inspektor për inspektimin administrativ	III-a
Ministria e Punëve të Brendshme	Drejtor i Njësisë Antitrafik	II-a
	Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit	III-a
	Koordinator në Njësinë Antitrafik	III-a
	Koordinator në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Prokurimeve të Përqendruara	III-a
Institucionet e pavarura	Inspektor (auditues i brendshëm) në Drejtoritë e Auditimit të Brendshëm, apo sektorët e auditimit të brendshëm.	III-b
Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të	Inspektor i Lartë	II-a
	Ndihmësinsektor i Lartë	II-b

Interesave.		
Autoriteti i Mediave Audiovizive	Kryetar i Këshillit të Ankesave	II-b
	Anëtar i Këshillit të Ankesave	III-a
	Përgjegjës i studios së transmetimit	III-a
	Monitorues	IV-a
Autoriteti i Konkurrencës	Inspektor i mbikëqyrjes së tregut. Inspektor i hetimit	III-a
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Inspektorë të ankesave dhe hetimit administrativ	III-a
Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	Inspektor	III-a
Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	Inspektor	III-a
<i>Komisioni i Prokurimit Publik</i>	<i>Inspektor</i>	<i>III-a</i>
<i>Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi</i>	<i>Inspektor</i>	<i>III-a</i>
<i>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme</i>	<i>Koordinator në Sekretariat (Drejtorinë e Përgjithshme) e BE-së</i>	<i>III-a</i>

Lidhja nr. 3/1

Kategorizimi për pozicionet e veçanta të punës për funksionet e veçanta në Kryeministri

Pozicioni	Kategoria e pagës
Drejtor njësie	II-a
Jurist Inspektor Koordinator	II-b
Koordinator	III-a

Lidhja nr. 3/2

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës në Departamentin e Administratës Publike

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Drejtor i Departamentit të Administratës Publike	I-b	1
Drejtor drejtorie	II-b	1
Përgjegjës sektori	III-a	1
Përgjegjës sektori	III-a/1	1
Specialist i nivelit të lartë	III-b	1 ose 2
Specialist i nivelit të mesëm	IV-a	1 ose 2 ose 3
Specialist	IV-b	1 ose 2 ose 3

Lidhja nr. 3/3

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës në Shkollën e Magjistraturës

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
<i>Kancelar</i>	<i>II-a</i>	<i>1</i>
Drejtor drejtorie	II-b	1

Këshilltar Akademik <i>Këshilltar për Botimet dhe Publikimet Shkencore</i>		
Përgjegjës sektori	III-a	1
	III-a/1	1
Redaktor shkencor Sekretar shkencor	III-b	1 ose 2
Specialist	III-b	1 ose 2 ose 3
Bibliograf	IV-a	1 ose 2 ose 3
Redaktor letrar	IV-b	1 ose 2 ose 3

Lidhja nr. 3/4

Nivelet e pagave të pozicioneve “ekspert”, në qendrat e ekselencës, pjesë e strukturës dhe organikës së institucioneve të administratës shtetërore
(shtuar me vendimin nr. 711, datë 24.11.2021)

POZICIONI	NIVELI I PAGËS MUJORE (LEK)	
	Në Kryeministri dhe aparatet e ministrive	Në institucionet e varësisë së Kryeministrit apo të ministrave
Ekspert i kategorisë së parë	132 000	114 000
Ekspert i kategorisë së dytë	114 000	95 000

Lidhja nr. 4

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve civilë/nëpunësve në institucionet e përcaktuara sipas pikës 1/1

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Sekretar i Përgjithshëm në: Kryeministri, Presidencë, Kuvend, Prokurori të Përgjithshme, Avokatit e Popullit	I-a	1
Sekretar i Përgjithshëm në: Ministri, institucionet e tjera të pavarura Drejtor Departamenti në Këshillin e Ministrave Drejtor i Departamentit të Administratës Publike Drejtor ekzekutiv i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri	I-b	1
Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Ndihmëskomisioner kategoria e parë në institucionin e Avokatit të Popullit Zëvendës drejtor ekzekutiv i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri <i>Kancelar i Gjykatës së Lartë</i>	II-a	1
Drejtor drejtorie Ndihmëskomisioner kategoria e dytë në institucionin e Avokatit të Popullit	II-b	1
Përgjegjës sektori <i>Kryesekretar gjyqësor</i>	III-a	1
	III-a/1	1
Specialist i nivelit të lartë <i>Sekretar gjyqësor</i>	III-b	1 ose 2
Specialist i nivelit të mesëm	IV-a	1 ose 2 ose 3
Specialist	IV-b	1 ose 2 ose 3
<i>Këshilltar ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë</i>	<i>Paga bruto fillestare e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë, pa përfitimet e tjera financiare, sipas referimeve të ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e</i>	<i>Sipas përcaktimeve të ligjit përkatës për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë</i>

Lidhja nr. 4/1

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve civilë gjyqësorë në gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, si dhe në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm
(ndryshuar me vendimin nr. 919, datë 25.11.2020)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Pjesa I – Niveli i parë i gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, si dhe i prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, sipas përcaktimit përkatësisht të KLGJ-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm		
Kancelar.	II-a	1
Drejtor drejtorie Ndihmësligjor në gjykatat e apelit	II-b	1
Kryesekretar Përgjegjës sektori	III-a	1
Përgjegjës sektori	III-a/1	1
Sekretar gjyqësor Sekretar në sekretarinë e prokurorisë Specialist	III-b	1 ose 2
Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3
	IV-b	
Pjesa II – Niveli i dytë i gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, si dhe i prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, sipas përcaktimit përkatësisht të KLGJ-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm		
Kancelar Ndihmësligjor në gjykatat e apelit	II-b	1
Drejtor drejtorie	III-a	1
Kryesekretar Përgjegjës sektori	III-a/1	1
Sekretar gjyqësor Sekretar në sekretarinë e prokurorisë	III-b	1 ose 2
Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3
	IV-b	
Pjesa III – Niveli i tretë i gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, si dhe i prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, sipas përcaktimit përkatësisht të KLGJ-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm		
Ndihmës ligjor në gjykatat e apelit	II-b	1
Kancelar	III-a	1
Kryesekretar Përgjegjës sektori	III-b	1
Sekretar gjyqësor Sekretar në sekretarinë e prokurorisë Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3
Specialist	IV-b	1 ose 2, ose 3

Lidhja nr. 4/2/a

Nivelet e pagave për funksionarët e kabineteve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë
(shtuar me vendimin nr. 214, datë 17.4.2019)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Drejtor i kabinetit të kryetarit të KLGJ-së. Drejtor i kabinetit të kryetarit të KLP-së.	I-a	1
Këshilltar në kabinetin e kryetarit të KLGJ-së.	Barazohet në pagë me zëvendësministrin	
Këshilltar në kabinetin e kryetarit të KLP-së.	I-b	
Ndihmës në kabinetin e kryetarit të KLP-së.	III-a	1
Sekretar i kryetarit të KLGJ-së. Sekretar i kryetarit të KLP-së.	Barazohet në pagë me sekretarin e Kryeministrit	

Lidhja nr. 4/2/b

**Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve
në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë**
(shtuar me vendimin nr. 214, datë 17.4.2019)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Sekretar i Përgjithshëm.	I-a	1
Drejtor Departamenti.	I-b	1
Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme. Drejtor Njësie. Nëpunës në njësinë përgjegjëse për vlerësimin e profesionalizimit dhe etikës së gjyqatrëve për vettingun në KLGJ.	II-a	1
Këshilltar i komisioneve të përhershme në KLGJ. Këshilltar në departamentin/njësinë përgjegjëse për shërbimet ligjore në KLP. Drejtor Drejtorie.	II-b	1
Përgjegjës/Shef Sektori.	III-a III-a/1	1
Specialist.	III-b	1 ose 2
Specialist.	IV-a IV-b	1 ose 2 ose 3

Lidhja nr. 4/3/a

Nivelet e pagave për funksionarët e kabinetit në Prokurorinë e Posaçme
(shtuar me vendimin nr. 876, datë 18.12.2019)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës paga e grupit
Këshilltar në kabinetin e drejtuesit të Prokurorisë	I-b	1
Sekretar i drejtuesit të Prokurorisë	Barazohet në pagë me sekretarin e Kryeministrit	

Lidhja nr. 4/3/b

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në Prokurorinë e Posaçme
(shtuar me vendimin nr. 876, datë 18.12.2019)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Kancelar	I-a	1
Drejtor drejtorie	II-b	1

Ekspert		
Përgjegjës sektori	III-a	1
	III-a/1	
Specialist	III-b	1 ose 2
Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3
	IV-b	

Lidhja nr. 4/4/a

Nivelet e pagave për funksionarët e kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

(shtuar me vendimin nr. 74, datë 31.1.2020)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Drejtor i kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	I-a	1
Këshilltar në kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	Barazohet në pagë me zëvendësministrin	
Ndihmës në kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	III-a	1
Sekretar i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	Barazohet në pagë me sekretarin e Kryeministrit	

Lidhja nr. 4/4/b

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

(shtuar me vendimin nr. 74, datë 31.1.2020)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Sekretar i Përgjithshëm	I-a	1
Inspektorë (jomagjistratë)	I-b	1
Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme	II-a	1
Drejtor drejtorie Ndihmës të inspektorëve	II-b	1
Përgjegjës sektori	III-a	1
	III-a/1	
Specialist	III-b	1 ose 2
Specialist	IV-a	1 ose 2 ose 3
	IV-b	

Lidhja nr. 4/5

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” dhe “drejtor ekzekutiv” në Qendrën për Teknologjinë e Informacionit për Sistemin e Drejtësisë

(shtuar me vendimin nr. 919, datë 25.11.2020)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit	Shtesa për kushte pune
Drejtor ekzekutiv	II-b	1	20.000
Specialist	III-b	1 ose 2	25.000

Lidhja nr. 5

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në institucionet qendrore të përcaktuara sipas pikës 1/2, të këtij vendimi

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Titullar i institucionit	II-a	1
Zv/titullar i institucionit Drejtor drejtorie Auditues i Parë në Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian	II-b	1
Anëtar i organit drejtues Auditues i Dytë në Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian Anëtar i Komitetit Shtetëror të Kulteve	III-a	1
Përgjegjës sektori Përgjegjës i Bibliotekës Shkencore në Akademinë e Shkencave	III-a/1	1
Përgjegjës sektori	III-b	1
Inspektor Redaktor në Akademinë e Shkencave Menaxher trajnimi në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA)	III-b	1 ose 2
Asistent Seksioni në Akademinë e Shkencave Bibliograf në Akademinë e Shkencave	IV-a	1 ose 2 ose 3
Specialist	IV-a	1 ose 2 ose 3
	IV-b	1 ose 2 ose 3

Lidhja nr. 5/1

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit
(ndryshuar me vendimin nr. 446, datë 26.7.2018; ndryshuar me vendimin nr. 115, datë 2.3.2022)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit	Shtesa për kushte pune
Titullar i institucionit.	I-b	1	75.000
Zëvendëstitullar i institucionit; Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbytjes në zyrën qendrore të AKSHI-t; Drejtor drejtorie të drejtorive IT të atashuara pranë Kryeministrit, ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore.	II-b	1	115.000
Drejtor drejtorie në drejtoritë mbështetëse.	II-b	1	0
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbytjes në zyrën qendrore të	III-a	1	72.000

AKSHI-t.			
Përgjegjës sektori në sektorët IT të atashuar pranë Kryeministrit, ministrive të linjës dhe pranë institucioneve qendrore.	III-a/1	1	20.000
Përgjegjës sektori në sektorët e atashuar pranë drejtorive rajonale të sistemit tatimor.	III-b	1	15.000
			5.000
Përgjegjës sektori të sektorëve të atashuar pranë institucioneve rajonale.	IV-a	1	15.000
			5.000
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës.	III-a/1	1	0
	III-b	1	0
Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes në zyrën qendrore të AKSHI-t.	III-b	1 ose 2	73.000
Specialist në sektorët apo drejtoritë IT të atashuar pranë Kryeministrit, ministrive të linjës dhe pranë institucioneve qendrore.	III-b	1 ose 2	25.000
Specialist në sektorët e atashuar pranë degëve doganore.	III-b	1 ose 2	15.000
			5.000
Specialist në sektorët apo drejtoritë IT të atashuar pranë institucioneve rajonale/vendore.	IV-b	1 ose 2 ose 3	15.000
	IV-c		5.000
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse.	IV-a	1 ose 2 ose 3	0
	IV-b		0

Për institucionet rajonale/vendore shtesën prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë e përfitojnë vetëm nëpunësit e strukturave TIK, të cilët punojnë me bazat e të dhënave shtetërore.

Lidhja nr. 5/2

Nivelet e pagave për punonjësit kërkimorë e shkencorë në Akademinë e Shkencave

Nr.	Emërtimi	Paga në lekë
1.	Kryetar i Akademisë së Shkencave	174.760
2.	Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave	153.300
3.	Akademik.	137.500
4.	Akademik i Asociuar Profesor	121.000
5.	Profesor i Asociuar	105.200

Shtesat mbi pagën mujore për funksione drejtuese, të punonjësve si më sipër

Pozicioni	Shtesa në lekë
Kryetar Seksioni. Sekretar Shkencor i Seksionit	12.000

Lidhja nr. 5/3

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në Inspektoratin Qendror dhe në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Elektronike

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit	Shtesa për kushte pune
Titullar i institucionit	II-a	1	15.000
Drejtor drejtorie	II-b	1	15.000

Përgjegjës sektori	III-a/1	1	20.000
Përgjegjës sektori në njësitë mbështetëse	III-a/1	1	0
Specialist	III-b	1 ose 2	25.000
Specialist në njësitë mbështetëse	IV-a	1 ose 2 ose 3	0
	IV-b	1 ose 2 ose 3	0

Lidhja nr. 5/4

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Titullar i institucionit	I-b	1
Drejtor drejtorie	II-b	1
Përgjegjës sektori	III-a/1	1
Specialist	III-b	1 ose 2

Lidhja nr. 5/5

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në Agjencinë Telegrafike Shqiptare
(shtuar me vendimin nr. 696, datë 22.11.2017)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës, paga e grupit
Titullar i institucionit.	I-b	1
Zëvendëstitullar i institucionit. Drejtor drejtorie	II-b	1
Përgjegjës sektori	III-a	1
	III-a/1	1
Specialist	III-b	1 ose 2
	IV-a	1 ose 2, ose 3
	IV-b	1 ose 2, ose 3

Lidhja nr. 5/6

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje
(shtuar me vendimin nr. 696, datë 22.11.2017; ndryshuar me vendimin nr. 443, datë 29.6.2022)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Titullar i institucionit	I-b	1

Drejtor drejtorie Koordinator	II-b	1
Koordinator Ndërmjetës Përgjegjës sektori në njësitë teknike të përmbytjes	III-a	1
Përgjegjës sektori në njësitë mbështetëse	III-a/1	1
Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3
	IV-b	1 ose 2, ose 3

Lidhja nr. 5/7

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

(shtuar me vendimin nr.116, datë 23.2.2018)

P o z i c i o n i	K r i t e r i m i n i m a l i d i p l o m ë s s ë s h k o ll ë s s ë l a r t ë p ë r e f e k t
---	--

	t ë p r a n i m i t n ë p o z i c i o n i n p ë r k a t ë s T ë p u n ë s P a g a e g r u p i t
T i t u l l a r i i n s t i t u c i	1

o n i t	
P ë r g j e g j ë s S e k t o r i n ë n j ë s i t ë e p ë r n b a j t j e s	1
P ë r g j e g j ë s S e k t o r i n ë n j ë s i	1

t ë n b ë s h t e t ë s e	
S p e c i a l i s t n ë n ; j ë s i t t ë e p ë r n b a ; j t ; j e s	1 o s e 2
S p e c i a l i s t n ë n ; j ë s i t t ë n b ë	1 o s e 2 o s e 3 1 o s e 2 o s e 3

s	
h	
t	
e	
t	
ë	
s	
e	

Lidhja nr. 5/8

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në Agjencinë e Prokurimit Publik

(shtuar me vendimin nr. 116, datë 23.2.2018; ndryshuar me vendimin nr. 711, datë 24.11.2021)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimi në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Titullar i institucionit	I-b	1
Drejtor drejtorie	II-b	1
Përgjegjës sektori në njësitë teknike të përmbajtjes	III-a	1
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës	III-a/1	1
Inspektor	III-b	1
Specialist në njësitë teknike të përmbajtjes	IV-a	1 ose 2, ose 3
Specialist	IV-b	1 ose 2, ose 3

Lidhja nr. 5/9

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “drejtor ekzekutiv” në Sekretariatit Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar

(shtuar me vendimin nr. 446, datë 26.7.2018)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimi në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Drejtor ekzekutiv	II-b	1
Përgjegjës sektori	III-b	1
Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3
	IV-b	1 ose 2, ose 3

Lidhja nr. 5/10

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës në administratën e Avokaturës së Shtetit

(shtuar me vendimin nr. 107, datë 6.3.2019)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimi në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Jurist	III-b	1 ose 2
Specialist	IV-a	1, ose 2, ose 3
Sekretar	IV-b	1, ose 2, ose 3

Lidhja nr. 5/11

Nivelet e pagave për punonjësit kërkimorë e shkencorë në Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

(shtuar me vendimin nr. 74, datë 31.1.2020)

Emërtimi	Paga në lekë
Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes nga kategoria “Profesor/Profesor i	123.800

asociuar	
Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes nga kategoria “Docent/Doktor”	106.700
Specialist në drejtoritë e përmbajtjes nga kategoria “Profesor”	121.000
Specialist në drejtoritë e përmbajtjes nga kategoria “Profesor i asociuar”	105.200
Specialist në drejtoritë e përmbajtjes nga kategoria “Docent/Doktor”	95.800

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës për nëpunësit e tjerë në Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Titullar institucioni	II-a	1
Drejtor drejtorie në drejtoritë mbështetëse	II-b	1
Përgjegjës sektori në drejtoritë dhe sektorët mbështetës	III-a/1	1
Specialist në drejtoritë dhe sektorët mbështetës	IV-a	1 ose 2 ose 3
	IV-b	

Lidhja nr. 5/12

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “drejtor i përgjithshëm”, “koordinator”, “drejtor drejtorie”, “përgjegjës sektori” dhe “specialist”, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës

(shtuar me vendimin nr. 711, datë 24.11.2021)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Drejtor i përgjithshëm	I-b	1
Koordinator Drejtor drejtorie	II-b	1
Koordinator Analist	III-a	1
Përgjegjës sektori	III-a	1
	III-a/1	1
Specialist	III-b	1 ose 2
	IV-a	1 ose 2, ose 3
	IV-b	1 ose 2, ose 3

Lidhja nr. 5/13

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “zëvendësdrejtor i përgjithshëm”, “zëdhënës i ministrit”, “koordinator”, “drejtor drejtorie”, “përgjegjës sektori” dhe “specialist”, në Agjencinë për Media dhe Informim

(shtuar me vendimin nr. 513, datë 18.9.2021)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm	I-b	1
Zëdhënës i ministrit Koordinator Drejtor drejtorie	II-b	1
Përgjegjës sektori	III-a	1
	III-a/1	1
Specialist	III-b	1 ose 2
	IV-a	1 ose 2 ose 3

	IV-b	1 ose 2 ose 3
--	------	---------------

Lidhja nr. 6

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në institucionet qendrore të përcaktuara sipas pikës 1/3/a, të këtij vendimi

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Titullar i institucionit	II-a	1
Zv/titullar i institucionit	II-b	1
